



BASHKIA  
TIRANË

## SHTOJCË

### MBI MODIFIKIMIN DHE NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE STANDARTE TË TENDERIT

Sot më datë 04.06.2020, Njësia e Prokurimit ju bën me dije si më poshtë vijon:

Autoriteti Kontraktor, në mbështetje të Nenit 42, pika 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut VII, Neni 62, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me nismën e vet, vendosi të bëjë ndryshimet në dokumentat e tenderit përmes hartimit të një Shtojce, e cila u komunikohet menjëherë të gjithë Operatorëve ekonomikë në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik duke u bërë detyruese për ta.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, vendosi të bëjë ndryshimet përkatëse në Dokumentat Standarte të Tenderit për procedurën e prokurimit me objekt **“Mbikqyrja e punimeve të objektit “Rindërtimi i banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim”** si më poshtë:

Në DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, **pika 2.3.2** ishte: *Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore:*

N.P – 2	Ndertime civile e Industriale.
N.P – 7	Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje
N.S – 1	Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S – 2	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre.
N.S – 4	Punime rifiniture të muratures dhe të lidhura me to, rifiniture me Materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyres teknike ndertuese.
N.S – 8	Ndertime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri
N.S - 12	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
N.S – 14	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.
N.S - 18	Punime topogjeodezike

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

**Bëhet**

*Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore:*

N.P – 2	Ndertime civile e Industriale.
N.P – 7	Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje
N.S – 1	Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S – 2	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre.
N.S – 4	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me Materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese.
N.S – 8	Ndertime parafabrikat me beton te armuar, struktura metalike dhe druri
N.S - 12	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
N.S – 14	Impiante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjisllacionit në fuqi.

Gjithashtu në DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, **pika 2.3.8** ishte: *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë OHSAS 18001-2007 (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. (Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme), **bëhet** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë OHSAS 18001-2007 / ISO 45001-2018 (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. (Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme).*

**Ju lutemi Operatorëve ekonomikë që do të paraqesin ofertat e tyre për këtë procedurë të marrin për bazë Shtojcën mbi modifikimin dhe ndryshimin e Dokumentave Standarte të Tenderit në platformën elektronike të APP –së.**

Nisur nga ky fakt, Njësia e Prokurimit në mbështetje të Nenit 42 pika 2/1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe në bazë të Kreut VII , Neni 62 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), vendosi të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e ofertave me 5 (pesë) ditë kalendarike.

Njësia e Prokurimit njofton të gjithë Operatorët ekonomik pjesmarrës se afati kohor për dorëzimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt: **“Mbikqyrja e punimeve të objektit “Rindërtimi i banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim”** është si më poshtë vijon:

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

**Data: 15.06.2020, Ora: 11:00**

**Vendi: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**

**Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

**Data: 15.06.2020, Ora: 11:00**

**Vendi: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**